



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1240 Prot

Tiranë, më 15/12/2015

Lënda: Jepet mendim mbi projektvendimin “ Për Rregullat për funksionimin, krijimin, administrimin, formatin, përmbajtjen dhe procedurat për sigurinë e regjistrit të investimeve strategjike”.

Drejtuar: Z. Frederik SEITI
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 7539/12 Prot, datë 09.12.2015, në projektvendimin “Rregullat për funksionimin, krijimin, administrimin, formatin, përmbajtjen dhe procedurat për sigurinë e regjistrit të investimeve strategjike” sugjerojmë rregullimet e mëposhtme.

Në pikën 6, të parashikohet e drejta e informimit që i duhet bërë subjekteve prej të cilëve merret informacioni. (Referojuni për këtë pikë 12 të Udhëzimit nr. 39, datë 5.08.2013 “Për përpunimin e të dhënave personale në Regjistrat Publik” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale).

Në fjalinë e parë të pikës 8, të hiqet togfjalëshi “...të dhënave të cilat konsiderohen sensitive”, pasi përkufizimi “të dhëna sensitive” përfshin një tjetër kategori të të dhënave personale. (Referojuni për këtë nenit 3/4 të ligjit nr. 9887, datë 10. 03. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar)

Në pikën 9 të zëvendësohet togfjalëshi “...të dhënave të ndjeshme”, pasi legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale por edhe ai në tërësi nuk njeh këtë term.

Në përfundim, sugjerojmë që personeli me akses në informacion, të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë e informacionit të përpunuar gjatë ushtrimit të funksionit por edhe pas përfundimit të tij, nëpërmjet nënshkrimit të një akti, (p.sh deklaratë e konfidencialitetit).

Me përshtatjen e këtyre pikave, ky projektvendim vlerësohet i hartuar konform kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

 Besnik DERVISHI
KOMISIONERI